



Nr. 1736/1 Prot.



BASHKIA  
TIRANË

42123 /6.11.2018

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

DHE

BASHKISË SË TIRANËS

TIRANË

MË DATË 21 / 10 /2019

Ky memorandum lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

**Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”**, (këtej e tutje UMSH), i krijuar me VKM nr.177, datë 19.02.2009, me seli në: Bulevardi Gjergj Fishta 52, 1023 Tiranë, përfaqësuar nga Akademiku **Gudar Beqiraj**, Rektor.

### ***DHE***

**Bashkia e Tiranës**, me adresë: “Sheshi Skënderbej”, Nd. 2, kodi postar 1001, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Erion Veliaj**.

## **Neni 1**

### **Objekti i Bashkëpunimit**

Objekti i këtij memorandum është përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit midis UMSH-së dhe Bashkisë së Tiranës. Institucionet e mësipërme bien dakord të bashkëpunojnë për një afat të pacaktuar kohor më njëra-tjetrën në fushat ku të dyja palët ushtrojnë aktivitetin e tyre kryesor dhe/ose plotësues. Pikat kryesore të bashkëpunimit do të jenë:

- *Kualifikim / Specializime*

UMSH do të ofrojë mundësinë për kualifikime afatgjata të ciklit Master Profesional dhe Master Shkencor.

- *Praktikë dhe Punësim*

Bashkia Tiranë në përputhje me domosdoshmëritë dhe mundësitë e disponueshme do të pranojë studentë në praktika profesionale/punësimi, internshipe, etj., duke iu dhënë mundësinë studentëve të UMSH-se të shfaqin/përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale, si dhe mundësi punësimi.

- *Projektet*

Palët bashkarisht bien dakord që në raste të aplikimeve dhe ose interesimeve në projekte të ndryshme kombëtare dhe ose ndërkombëtare do të kenë në konsideratë bashkëpunimin me njëri tjetrin në përputhje me kapacitetet përkatëse.

- *Leksione të Hapura*

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” do të krijojë mundësi për organizimin e leksioneve të hapura në fakultetet përkatëse.

Bashkia Tiranë do të mundësojë drejtues/specialist të fushave përkatëse për pjesëmarrjen në leksione të hapura. Datat e organizimit të leksioneve të hapura si dhe drejtuesit/specialistët që do të marrin pjesë në to janë eskuzivitet i palës përkatëse.

## Neni 2

### Të drejtat dhe detyrimet e palëve

- Palët marrin përsipër që në përputhje me interesat institucionale, mundësitë e tyre dhe kapacitetet përkatëse, të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës të gjitha burimet njerëzore dhe materiale, për arritjen e qëllimeve që parashikon ky memorandum.
- Palët do të nxisin njëra-tjetrën për një bashkëpunim sa më të gjerë dhe intensiv duke eksploruar fusha të tjera bashkëpunimi.
- Ky memorandum bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.
- Palët, në bazë të mundësive që disponojnë dhe potencialit akademik e profesional, do të aplikojnë në organizma dhe institucione të ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta.
- Palët do të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me informacionet që do të shkëmbejnë në kuadër të bashkëpunimit si dhe të respektojnë integritetin reciprok.

## Neni 3

### Komunikimi

Palët do të caktojnë personat e kontaktit që do të jenë përgjegjës për zbatimin e memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe efektiv.

Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të implementimit të këtij memorandumimi janë:

- Për Bashkinë  
Znj. Marsida Thartori  
Specialiste, Drejtorja e Trajnimit dhe Zhvillimit  
email: [marsida.thartori@tirana.al](mailto:marsida.thartori@tirana.al)
- Për Fakultetin  
Znj. Orkida Ilollari  
Pedagoge, Fakulteti Shkencave Ekonomike  
email: [orkida.ilollari@gmail.com](mailto:orkida.ilollari@gmail.com)

Në rast ndryshimi të personit të kontaktit palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën, në mënyrë që komunikimi të vijojë normalisht.



#### Neni 4

#### Ndryshime

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të të dy palëve të përfshira në të. Sipas rastit, për bashkëpunime specifike palët mund të nënshkruajnë akte në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### Neni 5

#### Kohëzgjatja e Memorandumit

Kohëzgjatja e këtij memorandumi do të jetë për një periudhë 3 vjeçare. Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë, me marrjen e njoftimit me shkrim nga njëra palë. Palët marrin përsipër t'u përmbahen termave dhe kushteve të projektit duke ofruar dhe shkëmbyer informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, deri në përfundim të bashkëpunimit.

#### Neni 6

#### Hyrja në fuqi

Ky memorandum bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga palët. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, një për secilën palë. Çdo ndryshim apo shtesë e këtij memorandumi do të bëhet vetëm në formë të shkruar.

*Ky memorandum shfuqizon çdo bashkëpunim të mëparshëm ndërmjet palëve.*

**UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË**

**BASHKIA TIRANË**

**Z. Gudar BEQIRAJ**

**Z. Erion VELIAJ**

**REKTORI**

**KRYETAR**

